REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

**QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE**
**DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT**

# ***N J O F T I M***

## ***PËR KANDIDATËT APLIKANTË PËR TESTIMIN E INFORMATIZUAR***

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 12, datë 27.02.2018 "Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t'u punësuar në institucionet arsimore publike, të arsimit parauniversitar" i ndryshuar, ju bëjmë me dije se gjatë muajve korrik-gusht 2019, pranë QSHA do të zhvillohet testimi i informatizuar për punësimin e mësuesve.

Në vijim do të publikohet kalendari me datat, oraret dhe profilet përkatëse për zhvillimin e testimit të informatizuar.

Testimi i informatizuar do të zhvillohet në godinën e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (më poshtë QSHA) me adresë: Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr. 23, Tiranë (ish-ATSH).

Kandidati duhet të paraqitet në QSHA **30 minuta para fillimit** të testimit të informatizuar.

Ditën e testimit, kandidati duhet të jetë i pajisur me:

1. Letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë, dokumenti origjinal);
2. Kopje të Kartës ID ose Pasaportës;
3. Formularin e pjesëmarrjes në testimin e informatizuar të lëshuar nga komisioni i vlerësimit të dosjeve në DRAP.

**Kandidatët, të cilëve u mungojnë këto dokumente, nuk mund të marrin pjesë në testimin e informatizuar.**

Për paraqitjen në qendrat e testimit, kandidati duhet të ketë parasysh rregullat e mëposhtme:

1. ndalohet **marrja me vete** dhe **përdorimi i celularëve** dhe mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të testimit, pasi kjo vlerësohet si kriter përjashtimi;

2. ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e testimit;

3. ndalohet komunikimi gjatë zhvillimit të testimit.

Për të gjithë kandidatët, lutemi të verifikoni **emrin, mbiemrin**, **profilin,** si dhe **datën** dhe **orën** e testimit në faqen zyrtare të QSHA, në adresën www.qsha.gov.al, faqja e parë “Provimet e Shtetit” dhe rubrika “Njoftime”, lista e kandidatëve për testimin e informatizuar.